

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Energjisë, Nëntor 2023

23.01.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon “Statistikat e Energjisë” për muajin nëntor 2023 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë.

Më shumë energji e konsumuar në nëntor 2023 sesa në nëntor 2022

Gjatë muajit nëntor të vitit 2023, energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 648.95 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 432.84 GWh ose 5,49% më shumë sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak.


Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 18,75%.

Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 5.06 mijë ton ose 16,04% më pak sesa në muajin e njëjtë të vitit paraprak.

Pasqyra e prodhimi, konsumit dhe raporti i energjisë elektrike në Nëntor 2023 me Nëntor 2022

MWH	11-2022	11-2023	XI 2023 / XI 2022 %
Prodhimi Bruto nga Termocentralet	531,340	522,780	-1.61%
Prodhimi Bruto nga Hidrocentralet	21,214	29,170	37.50%
Prodhimi Bruto nga Era dhe ajo Solare	38,623	51,998	34.63%
Importi	220,117	243,327	10.54%
Eksporti	194,671	198,320	1.87%
Energjia Elektrike bruto në Dispozicion	616,622	648,955	5.24%
Amvisni	248,637	259,634	4.42%
Komercial	97,222	104,481	7.47%
Industri	42,857	47,150	10.02%
Ndriqimi publik & tjerat	3,627	3,954	9.01%
Konsumatorët 220-110kv	8,855	9,527	7.59%
Mihjet	9,108	8,090	-11.18%
Konsumi i energjisë Elektrike	410,306	432,836	5.49%

Struktura e konsumit të energjisë elektrike Nëntor 2023



Për më shumë informata lidhur me publikimin e Statistikave të Energjisë në Kosovë, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/Energy>